



REPUBLIKA E MAQEDONISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

Nr 14-17211/1

29.12.2016

SHKUP

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për organizimin dhe punën e organeve të institucioneve shtetërore (“Gazeta Zyrtare” nr. 58/00, 44/02,82/08, 167/10 dhe 51/11), neni 5, të Rregullores për llojin e standardeve studentore dhe mënyrën për ndarjen e bursave për student të cilët studiojnë jashtë vendit (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 220/16) neni 4 dhe neni 7 të Rregullores për mënyrën dhe procedurën për financimin, krijimin dhe avancimin e kuadrove shkencore dhe hulumtuese (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 18/12, 64/13, 98/13, 70/14, 88/14, 74/15, 140/15 dhe 178/15), Ministria e Arsimit dhe Shkencës sjellë

## **AKTVENDIM**

### **për mënyrën e përcaktimit të llogaritjes për bursë mujore për studentët të cilët studiojnë jashtë vendit**

1. Me këtë Aktvendim përcaktohet mënyra e llogaritjes së shpenzimeve për bursë mujore për studentët të cilët studiojnë jashtë vendit, sipas Listës së indekseve të çmimeve të shitjes me pakicë për shpenzimet e jetesës” e cila është publikuar nga organet kompetente të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, dhe do të vlejë që nga dita e publikimit të Konkurseve të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për ndarjen e bursave për studime akademike të ciklit të parë, dytë përkatësisht viti i tretë jashtë vendit për vitin akademik 2017/2018 ( bursa në njëqind universitetet më të ranguara sipas shpalljes së fundit të listës që Qendrës të universiteteve të klasit botëror pranë Universitetit të Shangait Xhio Tong, bursa nga fusha e artit filmik Film Academy of Performing Arts (FAMU) në Pragë, Republika Çeke dhe bursa për të mësuarit e gjuhës së vjetër turke).

2. Vlera e bursës mujore llogaritet në bazë të formulës në vazhdim, duke shfrytëzuar indekset nga Lista e indekseve të çmimeve të shitjes me pakicë për shpenzimet e jetesës” e cila është publikuar nga organet kompetente të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, dhe është e vlefshme nga dita e publikimit të Konkurseve për ndarjen e bursave për studime akademike të ciklit të parë, dytë dhe tretë jashtë vendit për vitin akademik 2017/2018:

Indeksi i shpenzimeve për jetesë për Uashington, SHBA shumëzohet me 10. Kjo vlerë shumëzohet me indeksin e shtetit për të cilën studenti ka fituar bursë. Prodhimi ndahet me 100 dhe fitohet vlerë në dollar amerikanë. Kjo vlerë në dollarë amerikanë llogaritet në denarë, sipas kursit mesatarë të këmbimit të BPRM në ditën e sjelljes së Aktvendimit për mënyrën e përcaktimit të llogaritjes për bursë mujore për studentët të cilët studiojnë jashtë vendit

3. Vlera e përcaktuar në bazë të formulës nga paragrafi 2 i këtij Aktvendimi do të paguhet çdo muaj për të gjithë personat të cilët janë përzgjedhur si shfrytëzues të bursës, në bazë të Konkursit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për ndarjen e bursave për studime akademike të ciklit të parë, dytë përkatësisht ciklin e tretë jashtë vendit për vitin akademik 2017/2018.

4. Pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi është Lista e shpenzimeve për bursë mujore për studentët të cilët studiojnë jashtë vendit, të përzgjedhur në Konkursin për ndarjen e bursave për studime akademike për ciklin e parë, dytë përkatësisht ciklin e tretë jashtë vendit për vitin akademik 2017/2018. Si listë referencë e vendeve është marrë lista e universiteteve që i përkasin njëqind universiteteve më të ranguar sipas shpalljes së fundit të universiteteve globale për arsimin e lartë nga Instituti për Arsim të Lartë pranë Universitetit të Shangait Xhio Tong. Për vendet të cilat nuk përmenden në listën do të zbatohet formula nga paragrafi 2 i këtij Aktvendimi.

Ky Aktvendim hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij.

**Në vazhdim:** Lista e shpenzimeve për bursë mujore e studentëve të cilët studiojnë jashtë vendit

**Bursa mujore për vitin akademik 2017/2018 sipas vendeve të llogaritura në bazë të “ Listës së indekseve të çmimeve me pakicë për shpenzimet e jetesës” të cilën e shpallin organet kompetente të Organizatës së Kombeve të Bashkuara**

- Indeksi i OKB nga muaji gusht viti 2016

Kursi mesatarë i USD ( nga BPRM 29.12.2016) = 59,1091

Vendi	Qyteti referues	Shuma e bursës në MAQ
Australi	Sidnej	51.759 den.
Austri	Vienë	51.759 den.
Belgjikë	Bruksel	53.739 den.
Bosnje dhe Hercegovinë	Sarajevë	44.575 den
Brazil	Brazili	50.402 den.
Bullgari	Sofi	45.933 den.
Kanadë	Montreal	53.117 den.
Kinë	Pekin	51.646 den.
Kinë, Hong Kong	Hong Kong	54.248 den.
Republika Çeke	Pragë	45.763 den.
Danimarkë	Kopenhagë	54.192 den.
Finlandë	Helsinki	50.798den.
Francë	Paris	53.456 den.
Gjermani	Bon	49.214 den.
Hungari	Bukuresht	47.064 den.
Irlandë	Dublin	48.252 den.
Izrael	Eurosalim	54.078 den.
Itali	Romë	52.664 den.
Holandë	Hagë	50.798 den.

Norvegji	Oslo	53.569 den.
Federata Ruse	Moskë	52.042 den.
Singapur	Singapur	54.305 den.
Sllovaki	Bratislavë	46.555 den.
Slloveni	Ljublanë	46.612 den.
Spanjë	Madrid	48.761 den.
Suedi	Stokholm	49.214 den.
Zvicër	Gjenevë	62.224 den.
Turqi	Ankarë	45.706 den.
Britania e Madhe	Londër	54.305 den.
SHBA	Vashington	54.135 den.
Japoni	Tokio	58.264 den.
Arabia Saudite	Riad	50.175 den.
Argjentinë	Buenos Aires	51.872 den.
Kroaci	Zagreb	46.781 den.